



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit /Državni Tužilac /State Prosecutor
Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Državnog
Tužioca / Office of the Chief State Prosecutor



A.nr.119/2023

Datë: 25.04.2023

Prishtinë

UD/Kryeprokurori i Shtetit, në pajtim me nenin 1 paragrafi 1, pikat 1.1, 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit nr. Nr. 05/L-034, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-225 për Prokurorinë e Shtetit, me qëllim të zbatimit unik të praktikave lidhur me rastet që lidhen me konfiskimin e pasurisë, nxjerrë këtë:

UDHËZUES TË THJESHTËSUAR PËR KONFISKIMIN NË KOSOVË

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, pas hyrjes në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale të Kosovës, si dhe disa paqartësive që janë paraqitur në praktikë, lidhur me konfiskimin e pasurisë, konsideron se është e nevojshme që të lëshohet një udhëzues i thjeshtëzuar për konfiskimin e pasurisë, në mënyrë që kjo çështje të ketë një zbatim unik në praktikë.

KPRK (në vitin 2019) dhe KPP (shkurt 2023) si ligje të reja kanë hyrë në fuqi në periudha kohore të ndryshme dhe që kanë ndryshuar rrënjësisht mënyrën e sekuestrimit/konfiskimit.

Përderisa ish KPRK ka pasur disa nene që kanë rregulluar këtë fushë, në KPRK-në e re kemi vetëm nenin 92 që rregullon materien në fjalë. Pra, për zbatuesit e ligjit, është më e thjeshtë, më e lehtë dhe më konsistente përdorimi i autorizimeve ligjore në këtë fushë.

Ndërsa, KPP, ka ndryshime thuajse rrënjësore, por që këto ndryshime janë bërë për të evituar sfidat dhe problemet që janë hasur në praktikë. Kështu, përderisa në ish KPP-në e vjetër kemi pasur afate të ndryshme tek ngrirja dhe sekuestrimi (3 respektivisht 5 ditë) dhe po ashtu ka pasur procedura të ndryshme për ngrirjen dhe sekuestrimit, tash me ndryshimet e reja, do të jetë shumë

më i lehtë zbatimi neneve që kanë të bëjnë me sekuestrimin dhe konfiskimin, sepse kemi një afat të vetëm (afati 7 ditësh për UNP) dhe kemi një procedurë të thjeshtë dhe të vetme për procedurën që duhet të ndiqet.

KPRK dhe KPP përmbajnë nene me mundësi procedurale që më herët nuk kanë qenë. Mesazhi i përgjithshëm që dërgohet është se “KRIMI NUK SHPAGUHET”, dhe se herët a vonë, shteti përmes mekanizmave ligjor do të bëjë konfiskimin e dobisë pasurore të kundërligjshme.

Një ndryshim i madh psh vërehet tek neni 92 që përcakton se fillimisht tentohet të konfiskohet dobia pasurore e përfitur me vepër penale dhe mjete i përdorur në kryerjen e veprës penale. Kur një gjë e tillë ndodh, atëherë procedura rreth konfiskimit përfundon në atë hap, mirëpo nëse për çfarëdo arsye dobia pasurore apo instrumentaliteti më nuk është në dispozicion për tu konfiskuar, atëherë, gjykata ka mundësinë e përcaktimit të vlerës së barasvlershme. Kur as kjo nuk është e mundur, neni 92 ka përcaktuar një mundësi shtesë që nuk ka ekzistuar më parë dhe kjo është konfiskimi i SECILËS pasuri të te pandehurit me vlerë të barasvlershme dhe kjo pasuri mund të jetë edhe nëse bëhet fjalë për pasurinë e ligjshme të te pandehurit.

Futja në KPRK dhe KPP e konceptit të vlerës zëvendësuese ka për qëllim ti japë efekt të plotë juridik dispozitës që gjendet në nenin 92.2 të KPRK-së.

Neni 92.2 i KPRK-së ka për qëllim të sigurohet që në rast se i pandehuri përfiton dobi pasurore nga një vepër penale, dhe dobia e caktuar nuk gjendet akoma në dispozicion, atëherë gjykata mund të konfiskojë pasuri shtesë të te pandehurit (e ligjshme sipas prejardhjes) deri në vlerën e dobisë pasurore. Ky nen është hartuar që të sigurojë parimin se një i pandehur nuk duhet të përfitojë nga aktiviteti i tij/saj kriminal.

Ish neni 97.1 i KPRK-së së vitit 2013 nuk është përdorur gjerësisht nga prokurorët apo gjykatat, dhe që mundëson që të obligojë të pandehurin që të paguaj vlerën zëvendësuese në vend se të konfiskojë zëvendësim e vlerës. Po ashtu, as ish KPP e vjetër nuk ka pasur dispozita për bllokimin e pronës së tillë shtesë. Kjo tashmë është korrigjuar me ndryshimet e bëra si në nenin 92 të KPRK-së, ashtu edhe në dispozitat e reja që janë përfshirë në KPP.

Andaj, dispozitat e reja mundësojnë situatat kur konfiskimi nuk mund të realizohet nga pasuritë e të pandehurit apo të një pale të tretë që ka pranuar pronën e transferuar. Në rastin e tillë këta persona do të duhet të paguajnë një shumë të hollash që përkojnë me vlerën e pronës që i nënshtrohet konfiskimit dhe gjykata mund të urdhërojë konfiskimin e pronës së tillë.

Për më tepër, neni 97.1 i ish KPRK-së së vitit 2013 i referohet vetëm të pandehurit e jo palës së tretë e cila ka pranuar pronën e transferuar e cila nuk është më në dispozicion për konfiskim. Kjo situatë është korrigjuar si në nenin 92 të KPRK-së ashtu edhe në dispozitat e reja në KPP. Ndryshime të reja janë përfshirë edhe në nenin 19 të KPP-së, apo tek Përkufizimet. Nenin 19.1.34 – 19.1.41 përmbajnë një gjuhë të harmonizuar dhe konsistente përgjatë gjithë KPP-së, madje edhe LKZK-së, dhe për zbatuesit e ligjit do të jetë shumë më e lehtë, më e qartë dhe më e kuptueshme rruga procedurale e zbatimit të tyre. Kështu, edhe nëse ka pasur ndonjë dilemë eventuale e zbatimit të ndonjë dispozite, tashmë tek neni 19 apo përkufizimet, është përdorur një gjuhë e tillë e cila do të ndihmojë jashtë mase zbatuesit e ligjit në të kuptuarit më të mirë, më të lehtë dhe më të qartë të këtyre dispozitave.

Përgjatë, fatkeqësisht paraqet neni 279 i KPP-së, apo Urdhri për Zbulim të Informacionit, që dallon nga neni 18 i LKZK-së dhe tashmë nuk është e qartë se cila do të jetë mundësia e reagimit të prokurorisë/gjykatave, në rast se një person refuzon të veproj sipas kërkesave nga ky nen.

Për ta qartësuar këtë, ndryshimet në nenin 279 të KPP-së kanë rrjedhur nga Kuvendi i Kosovës, në momentin e fundit dhe ne nuk kemi informacion as pse e as si ka ardhur deri te ky ndryshim.

Për këtë arsye edhe nuk kemi përfshirë nenin në fjalë në këtë Udhëzues sepse vetëm rastet praktike sipas të gjitha gjasave mund ta zbërthejnë batimin apo pamundësinë e zbatimit në praktikë në nenit në fjalë.

Një rëndësi të posaçme e marrin edhe sqarimet që kanë të bëjnë me shitjen apo tjetërsimin e aseteve në fazën sa më të hershme të sekuestrimit të një aseti. Sërish, në të kaluarën ka pasur

hezitime të shitjes së aseteve të tilla, dukë bërë kështu që buxheti i vendit të dëmtohet eventualisht sepse pas kalimit të afatit prej disa vitesh, asetet në fjalë janë zhvlerësuar.

Në këtë Udhëzues, inkurajohen prokurorët që:

- Të rrisin bashkëpunimin me AAPSK-në për të bashkëpunuar me Planifikimin para sekuestrimit për të rritur gjasat e sekuestrimit të suksesshëm;
- Të zbatojnë sa më shpesh dispozitat e KPP-së që lejojnë dhe inkurajojnë shitjen në fazë sa më të hershme të aseteve që zhvlerësohen;
- Që të evitojnë situatat e paraqitura në të kaluarën dhe të bëjnë dallimin e lejueshmërisë së shitjes së aseteve si dobi pasurore dhe atyre të listuara në aktakuzë si provë, sepse asetet e listuara si provë nuk mund dhe nuk duhet të propozohen për shitje dhe
- Të përpilojnë arsyetime më të mira të këtyre propozimeve për të rritur gjasat për aprovim të kërkesave të tilla nga ana e gjykatave.

Zbatimi i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)

Kapitulli VII - Konfiskimi i instrumentalisht dhe dobisë pasurore të veprave penale

Neni 92

Konfiskimi i mjeteve dhe dobisë pasurore të veprave penale

1. Pasuria ose mjeti që është përfituar me vepër penale konfiskohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.
2. Kur konfiskimi nuk është i mundur në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, Gjykata urdhëron kryesin e veprës për të paguar një shumë të barasvlershme ose Gjykata do të konfiskojë çdo pasuri të të pandehurit me vlerë të barasvlershme siç është përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

1. KPRK mund të zbatohet vetëm pasi që prokurori siguron një aktgjykim dënues për një të pandehur për veprat penale të përshkruara në aktakuzë.

SHEMBULL: Dy të pandehur akuzohen për veprën penale të grabitjes nga neni 317 i KPRK-së, me ç' rast të njëjtit kanë grabitur shumën prej 50,000 € të gatshme dhe me rastin e kryerjes së veprës penale kanë përdorur veturën Mercedes për të shkuar dhe për t'u larguar me shpejtësi nga vendi i ngjarjes. Ndërkohë, gjykatat sjellin aktgjykim dënues, i cili bëhet i formës së prerë.

2. Krahas marrjes së aktgjykimit dënues, prokurori në aktakuzë duhet të kërkojë që të konfiskohet shuma prej 50.000 euro para të gatshme si dobi pasurore si dhe mjete i cili është përdorur në kryerjen e veprës penale, që është vetura Mercedes. Ky është hapi i parë që e kërkon prokurori, dhe nëse eventualisht shuma prej 50.000 euro dhe vetura gjenden dhe konfiskohen, atëherë procedura e konfiskimit sa i përket nenit 92 përfundon. Mirëpo, nëse gjendet vetëm një sasi e vogël e parave dhe vetura Mercedes nuk është në dispozicion, atëherë prokurori aplikon hapin e dytë, që është pagimi i një shume të barasvlershme. Kjo nënkupton që nëse është gjetur shuma prej 20.000 euro, prokurori duhet t'i kërkojë gjykatës që përveç konfiskimit të shumës prej 20.000 euro, gjykata të urdhërojë që i pandehuri të paguajë edhe shumën tjetër prej 30.000 euro, si dhe vlerën që e ka pasur vetura. Nëse i pandehuri paguajnë shumën në fjalë si për dobinë pasurore, ashtu edhe për instrumentalitetin, atëherë procedura penale rreth konfiskimit mund të përfundojë me hapin e dytë. Ndërsa, nëse për çfarëdo arsye hapi i dytë është i pamjaftueshëm sepse nuk mund të inkasohet as vlera zëvendësuese, atëherë prokurori kalon në hapin e tretë, që është kërkesa që gjykata të konfiskojë çdo pasuri tjetër të të pandehurit, deri në përmbushjen e plotë të vlerës prej 50.000 euro si dhe vlerës së instrumentalitetit.

Zbërthimi i procedurës së konfiskimit sipas KPRK-së:

Hapi 1: Krahas dënimit për veprën penale, konfiskohet shuma e dobisë pasurore (sipas shembullit, shuma prej 50.000 euro dhe vetura Mercedes).

Hapi 2: Kur hapi i parë është i pamjaftueshëm, atëherë urdhërohet pagesa e një shume të barasvlershme.

Hapi 3: Konfiskimi i çdo pasurie tjetër deri në përmbushjen e vlerës së plotë të dobisë pasurore dhe të instrumentaliteteve. Termi “pasuri tjetër” nënkupton edhe mundësinë e konfiskimit të pasurisë së ligjshme që nuk është e propozuar në aktakuzë. Kjo përfshin edhe pasurinë tek pala e tretë ashtu siç përcaktohet në nenin 273 të KPPRK-së.

Zbatimi i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK)

Nenet 259, 260 dhe 261 përmbajnë dispozita të përgjithshme për përkufizimin e pasurisë që mund t'i nënshtrohet konfiskimit.

Janë dy procedura:

Procedura për urdhër ndalues të përkohshëm; dhe

Procedura për urdhër ndalues përfundimtar.

Këto nene përcaktojnë se procedurat e ndalimit bëhen me shkrim, përveç nëse gjykata urdhëron ndryshe.

Urdhri ndalues i përkohshëm lëshohet nga Prokurori i Shtetit sipas nenit 260 dhe ka efekt prej 7 ditësh, brenda këtij afati kohor 7 ditësh prokurori duhet të paraqesë kërkesën për urdhrin ndalues përfundimtar sipas nenit 261.

Për dallim nga ish-KPPRK, KPP i ri parasheh një afat më të gjatë për prokurorin dhe urdhri ndalues i përkohshëm mbetet i vlefshëm derisa gjykata të vendosë mbi aprovimin apo refuzimin e kërkesës për urdhrin ndalues përfundimtar.

NENI 260 parasheh se kush e lëshon Urdhrin ndalues të përkohshëm, pastaj formën se çka duhet të përfshijë urdhri ndalues i përkohshëm dhe cilat veprime procedurale duhet të merren nga Prokurori dhe institucionet e tjera brenda këtij afati.

Neni 261 parasheh formën se çka duhet të përfshijë kërkesa për urdhër ndalues përfundimtar.

Është e rëndësishme që prokurorët të zbatojnë nenin 261.3 të KPPRK-së apo të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të njoftuar të pandehurin apo personin i cili ka interes në lidhje me kërkesën për urdhër ndalues përfundimtar. Në të kaluarën prokurorët nuk e kanë zbatuar nenin në fjalë dhe kjo ka sjellë deri te ankesat e suksesshme të të pandehurve vetëm mbi këtë bazë.

Neni 262-Masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë së specifikuar

Neni 262 përcakton masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë së specifikuar dhe është shumë e rëndësishme që prokurorët ta zbatojnë nenin në fjalë dhe po ashtu të fusin në përdorim PLANIFIKIMIN para sekuestrimit. Kjo për shkak se mund të bëhet fjalë për pajisje të rënda të cilat AAPSK duhet t'i kontaktojë për marrëveshjet mbi transportin e atyre sendeve, si dhe kur bëhet fjalë për vetura të vjetra me vlerë tejet të vogël.

Prokurorët duhet të përkujdesen veçanërisht që kërkesat për shitje të aseteve që zhvlerësohen shpejt, t'i bëjnë në fazë sa më të hershme të procedurës penale dhe po ashtu të përkujdesen që të mos kërkojnë shitjen e aseteve që janë të listuara si provë.

Prokurorët inkurajohen që të kenë kujdes të shtuar tek konfiskimi i telefonave të përdorur dhe në situata të tilla duhet të mbizotërojë qëndrimi që këta telefona të asgjësohen në përfundim të procedurës penale, respektivisht me aktgjykim përfundimtar.

Neni 263-Të drejtat e të pandehurit dhe palës së tretë para nxjerrjes së urdhrit ndalues përfundimtar

Neni 263 siguron se i pandehuri dhe cilado palë e tretë mund të kundërshtojë kërkesën e prokurorit për urdhër ndalues përfundimtar dhe përcakton se çka duhet të përmbajë kundërshtimi i të pandehurit apo palës së tretë.

Neni 264-Nxjerrja e urdhrít ndalues përfundimtar

Neni 264 përcakton procedurën që ndiqet nga gjykata për nxjerrjen e urdhrít ndalues përfundimtar dhe se gjykata vendos brenda 30 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës, ndërsa urdhri ndalues përfundimtar përkruhet në nenin 265.

Neni 266-Urdhri ndalues i përkohshëm për pasuritë shtesë të specifikuara

Neni 266 përcakton urdhrin ndalues të përkohshëm që lëshohet nga gjykata me kërkesë të prokurorit.

Neni 268-Bazat për ankesë për lëshimin ose refuzimin e urdhrít ndalues përfundimtar

Neni 268 përcakton bazat për ankesë për lëshimin ose refuzimin e urdhrít ndalues përfundimtar që mund të bëhet brenda 15 ditëve nga pranimi i urdhrít me shkrim.

Ankesa e palëve nuk e pezullon ekzekutimin e urdhrít.

Neni 269-Konfiskimi

Parakusht për marrjen e urdhrít për konfiskim është që të pandehurit të shpallen fajtor për veprat penale. Sipas këtij neni dhe sipas shembullit më lart, gjykata fillimisht i shpallë të pandehurit fajtor për veprën penale të grabitjes dhe konstaton se të pandehurit kanë krijuar dobi pasurore prej 50.000 euro, e cila dobi pasurore konfiskohet me aktgjykim. Nëse vlera prej 50.000 euro nuk ka mundur të konfiskohet për çfarëdo arsye, por për shembull është gjetur dhe konfiskuar shuma prej 20.000 euro, që do të thotë se shuma prej 30.000 euro nuk ka mundur të konfiskohet. Nëse ka ndodhur kjo, gjykata urdhëron përcaktimin e vlerës monetare që në rastin konkret do të ishte shuma prej 30.000 euro. Nëse të pandehurit nuk mund ta paguajnë shumën prej 30.000 euro, atëherë gjykata konfiskon çdo pasuri tjetër si zëvendësim i vlerës.

Nëse dobia pasurore do të ishte pikturë dhe vlera e saj rritet apo zvogëlohet deri në momentin e konfiskimit, si vlerë më e madhe do të përcaktohet ajo e cila është vlera më e madhe.

Neni 270-Konfiskimi i mjetit

Neni 270 nënkupton urdhrin për konfiskimin e pasurisë që është përdorur në kryerjen e veprës penale e që në rastin sipas shembullit është vetura Mercedes që ka ndihmuar në kryerjen e veprës penale. Për më shumë detaje dhe për sqarim në arsyetimin e aktakuzës, prokurori duhet t'i referohet nenit 19, par.1, nënpar.1.38.

Nëse instrumentaliteti në fjalë i takon palës së tretë, prokurori kërkon dhe gjykata e konfiskon mjetin në fjalë vetëm nëse pasuria ka qenë dhuratë e njollosur sipas nenit 19, par.1, nënpar.1.40.

Për dallim nga ish KPP, neni 19.1.1.38 përmban një gjuhë shumë më gjithëpërfshirëse, dhe prokurori në kërkesën e tij për konfiskim duhet të provojë nëse instrumentaliteti i tillë është përdorur në kryerjen e veprës penale, si është përdorur, si ka ndihmuar në kryerjen e veprës penale. Neni 19.1.1.38 përcakton se mjafton që mjeti i tillë të ketë ndihmuar qoftë edhe NDONJË element i veprës penale, apo nëse është përdorur qoftë edhe vetëm nëse është përdorur për të udhëtuar në vendin ku është kryer ndonjë element i veprës penale apo është përdorur vetëm për tu larguar nga vendi i tillë.

Poashtu, ky nen, mes tjerash si kriter për konfiskim parasheh edhe mundësinë që mjeti në fjalë vetëm të ketë lehtësuar NDONJË veprim në mbështetje të veprës penale.

Neni 273-Zëvendësimi i vlerës së pasurisë

Nëse sipas shembullit si më lart, gjykata konstaton se të pandehurit kanë pranuar dobi pasurore prej 50.000 euro nga vepra penale e grabitjes dhe shumën prej 30.000 euro e kanë bartur tek një person tjetër dhe ajo shumë nuk ka mundur të konfiskohet, gjykata ka mundësi që të pandehurve apo madje edhe palës së tretë t'ua konfiskojë çdo pasuri tjetër deri në vlerën monetare të dobisë pasurore, që në rastin konkret do të ishte shuma prej 30.000 euro, pavarësisht se kjo pronë nuk është e përshkruar në aktakuzë.

Që të mund të zbatohet paragrafi 1 i nenit 273, prokurori duhet t'i paraqesë gjykatës prova të pasurisë shtesë të të pandehurit apo palës së tretë.

I pandehuri ose pala e tretë mund ta evitojë konfiskimin e pasurisë së tillë nëse pranon që ta paguajë shumën për zëvendësimin e vlerës, që në rastin sipas shembullit do të ishte shuma prej 30.000 euro.

Nuk ka afat kohor brenda të cilit mund të identifikohet dhe konfiskohet pasuria e tillë.

Neni 274- Procedura e konfiskimit gjatë shqyrtimit gjyqësor

Neni 274 përcakton se qoftë prokurori, qoftë i pandehuri, apo pala e tretë kanë mundësi të bëjnë parashtrës, të paraqesin prova, të marrin në pyetje dëshmitarë, të paraqesin prova të tjera, të thërrasin ekspertë në lidhje me pasurinë e specifikuar.

Ky nen kërkon një standard më të lartë për gjykatën sa i përket trajtimit të konfiskimit meqenëse kërkon që çdo send i pasurisë së specifikuar të trajtohet veçmas në aktgjykimin e gjykatës.

Neni 275 -Konfiskimi i pasurive shtesë pasi që aktgjykimi të jetë përfundimtar

Neni 275 nënkupton që pasi që gjykata e dënon të pandehurin për veprë penale, konstaton se të pandehurit kanë marrë dobi pasurore ose kanë bërë dhuratë të njollosur dhe se kjo dobi pasurore ose dhuratë e njollosur tërësisht apo pjesërisht nuk ka mundur të konfiskohet për çfarëdo arsye, atëherë në një situatë të tillë mund të konfiskohet edhe pasuria shtesë në çdo kohë pasi që aktgjykimi të marrë formën e prerë.

Në kuptim të shembullit ilustrativ, kërkohet që fillimisht gjykata t'i shpallë fajtorë të pandehurit për veprën penale të grabitjes, të konstatojë se të pandehurit kanë përfituar dobi pasurore prej 50.000 euro (eventualisht vetura Mercedes është transferuar tek një palë e tretë), dhe se janë rikuperuar vetëm 20.000 euro, ndërsa 30.000 nuk kanë mundur të konfiskohen. Pra, shuma prej

30.000 euro mund të konfiskohet nga pasuritë shtesë të identifikuara edhe për shembull 5 apo 10 vjet pas aktgjykimit të formës së prerë, që nënkupton që nëse p.sh. prokurori zbulon se të pandehurit në ndërkohë kanë blerë një banesë në vlerë prej 100.000 euro apo kanë blerë një veturë të re në vlerë prej 40.000 euro, prokurori mund t'i kërkojë gjykatës konfiskimin e pasurisë së tillë, ku nga shitja e banesës - 30.000 euro do të derdreshin në buxhetin e shtetit, ndërsa pjesa tjetër nëse nuk ka bazë për konfiskim të zgjeruar, do t'i kthehet të pandehurit.

Neni 276-Pasuria që i nënshtrohet automatikisht konfiskimit

Ky nen përcakton se një pasuri i nënshtrohet konfiskimit në cilëndo fazë të procedurës nga gjyqtari kompetent, nëse plotësohet kriteri që pasuria të jetë:

Qenësisht e rrezikshme; apo

E paligjshme.

Nëse bëhet fjalë për pasuri sipas kriterëve më lart, pasuria konfiskohet pa marrë parasysh fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit, apo faktin se a ka ndërmarrë prokurori ndonjë veprim.

Neni 277-Urdhri i arsyetuar për konfiskimin e pasurisë

Neni 277 përcakton se aktgjykimi brenda vetes përmban edhe urdhrin e arsyetuar për secilin send që konfiskohet. Për më tepër detaje, prokurorët dhe gjyqtarët inkurajohen që t'i referohen edhe Udhëzuesit të Gjykatës Supreme, nr.62/20, i datës 02.03.2020.

Neni 278-Hetimi për konfiskimin

Ky nen është një dispozitë e re që nuk ka ekzistuar në Kodet e mëparshme dhe që lejon hetimin për konfiskim si në fazën e hetimit penal, pas ngritjes së aktakuzës, para shqyrtimit gjyqësor, gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.

Hetimi për konfiskim nuk duhet të identifikohet me hetimin penal. Pra, hetimi për konfiskim është hetim i ndarë, dhe aty nuk vlejné afatet kohore sikur tek hetimi penal, dhe nuk vlejné as aspektet tjera procedurale për të pandehurit dhe veprën penale.

Hetimi për konfiskim sipas këtij neni nuk duhet të identifikohet me hetimin për konfiskim nga neni 17 i LKZK-së sepse në këtë rast, pra sipas nenit 278 të KPPRK-së, i pandehuri duhet të shpallet fajtor (grabitja), të konstatohet dobia pasurore (50.000 euro), dhe konfiskimi të mos mund të inkasohet në vlerën e plotë (janë inkasuar 20.000 euro, kurse 30.000 kanë mbetur të pa rikuperuara).

Neni 279-Urdhri për zbulim të informacionit

Neni 279 i siguron prokurorit një mjet të ri hetimi për të identifikuar pasuritë që mund të përfshihen në kërkesën për konfiskim. Futja e nenit të tillë ka qenë e nevojshme pasi që dispozitat e ish-KPPRK kanë qenë joadekuate. Në mënyrë që të sigurohet që kërkesa për konfiskim të pasurisë të përfshijë sa më shumë mundësi për identifikim të pasurisë së të pandehurit, urdhri për zbulim të informacionit zgjeron fushëveprimin e kompetencave hetuese që aktualisht janë në dispozicion tek prokurori. Urdhri për zbulim të informacionit duhet të nxjerret nga gjykata me kërkesë të prokurorit. Ky urdhër mund të lidhet me secilin person që prokurori beson se ka informacion relevant lidhur me hetimin për konfiskim.

Ky udhëzim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeprokurori i Shtetit.

Udhëzimi i dërgohet:

Kryeprokuroreve të prokurorive themelore dhe të gjithë prokurorëve të shtetit
Arkivit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit



Besim Kelmendi
Udhëzues Kryeprokurori i Shtetit